



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 174, datë 01.12.2023

**PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË  
DURRËS DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE  
FUNKSIONIMIN E TIJ**

Referuar Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizimit të Dhunshëm dhe Plani i Veprimit, Akteve Ndërkombëtare si: Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e amenduar dhe Praktika të Mira për Ndërtimin e Partneritetit Polici-Publik botuar nga OSCE (2008) si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK  
V E N D O S I :**

1. Miratimin e krijimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Durrës dhe rregulloren për organizimin dhe funksionimin e tij, bashkëngjitur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi administrata e Bashkisë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 04.12.2023**

# RREGULLORE PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË DURRËS

## NENI 1 OBJEKTI

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i përbërjes, detyrave, përgjegjësi si dhe mënyra e funksionimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike pranë Bashkisë Durrës.

## NENI 2 BAZA LIGJORE

- 1.Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- 2.Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.
- 3.Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.
- 4.Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.
- 5.Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar.
- 6.Ligji nr. 103/2014 “Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë”.
- 7.Ligji nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.
8. VKM nr.930, datë 18.11.2015 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizimit të Dhunshëm dhe Plani i Veprimit”.

## NENI 3 QËLLIMI

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave që zbatohen për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit Vendor i Sigurisë Publike (KVSP) pranë bashkisë. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike (KVSP) funksionin si një mekanizëm koordinues, identifikues dhe menaxhues pranë bashkisë mbi problematikat që lidhen me sigurinë e komunitetit për çështje të rendit dhe sigurisë publike. KVSP nuk ushtron veprimtari me interes ekonomik dhe për këtë arsye nuk ka buxhet të veçantë. Qëllimi i KVSP-së është të kontribuojë në rritjen e sigurisë publike si një organ këshillimor në Bashki nëpërmjet:

- Identifikimin e problemeve në lidhje me sigurinë dhe rendin publik;
- Rritjes së ndjenjës së sigurisë;
- Nxitjes së angazhimit të komunitetit në çështjet e sigurisë publike;
- Identifikimit të pikave të nxehta përsa i përket situatës kriminale, aksidenteve në qarkullimin rrugor, sjelljeve anti-shoqërore dhe kundërvajtjeve dhe marrjen e masave për zbutjen e këtyre rreziqeve;



- Hartimi i rekomandimeve dhe aktiviteteve për rritjen e sigurisë dhe rendit publik drejtuar autoriteteve përgjegjëse për identifikimin e çështjeve që paraqesin rrezik për sigurinë dhe rendin publik;
- Diskutimi i raporteve dhe të dhënave lidhur me sigurinë në bashki dhe identifikimin e masave për adresimin e problemeve;
- Hartimi dhe /ose dhënia e rekomandimeve mbi Planet e Veprimit për Sigurinë Publike;
- Komunikimi dhe informimi i vazhdueshëm i institucioneve përgjegjëse për sigurinë publike dhe sociale mbi problematikat e identifikuara dhe elementët e tjerë të lidhur me sigurinë publike, etj.

## NENI 4 PËRBËRJA

Këshilli Vendor i Sigurisë Publike përbëhet si më poshtë:

- Kryetar i Bashkisë Durrës.
- Kryetar i Këshillit Bashkiak.
- Anëtar i Këshillit Bashkiak që siguron përfaqësimin e çdo partie politike në Këshillin Bashkiak.
- Përfaqësues nga Policia Bashkiake.
- Përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Durrës.
- Përfaqësues nga njësia për mbrojtjen e fëmijëve dhe kundër dhunës në familje
- Përfaqësues nga Emergjencat Civile, Bashkia Durrës.
- Përfaqësues nga Prefekti i Qarkut Durrës.
- Përfaqësues nga Komisariati i Policisë Durrës.
- Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Mjedisit.
- Përfaqësues i Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor.
- Përfaqësues nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiskionit të Përgjithshëm Durrës.
- Përfaqësues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor të Juridiskionit të Përgjithshëm Durrës.
- Përfaqësues i Policisë së Qarkut.
- Përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës.
- Përfaqësues nga Drejtoria e Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror.
- Përfaqësues nga komuniteti i biznesit.
- Përfaqësues nga secili komunitet fetar.
- Përfaqësues nga OJF-të.
- Përfaqësues nga Media.

Në varësi të temave të rendit të ditës mund të ftohen në mbledhje edhe anëtarë të tjerë që nuk janë pjesë e KSVP-së. Njoftimi i anëtarëve ose i të ftuarve bëhet nga Kryetari dhe/ose anëtarët e tjerë të KVSP-së.

## NENI 5 PËRGJEGJËSITË E KVSP

1. Mbështet dhe inkurajon një partneritet të qëndrueshëm me të gjitha institucionet e përfshira në KVSP me qëllim identifikimin dhe parandalimin e problematikave në kuadër të sigurisë publike



3. Sipas rastit, KVSP komunikon me institucionet e qeverisjes qendrore për zbatimin e masave për parandalimin e krimit.
4. Mbështet dhe koordinon me organizata të shoqërisë civile, komunitetet fetare, komunitetin e biznesit angazhime konkrete në përballjen me sfidat e sigurisë në komunitet me qëllim parandalimin e konflikteve, sjelljeve antishoqërore, si dhe veprimeve të tjera të dhunshme.
5. Realizon dhe vlerëson takimet konsultuese publike me përfaqësues të komuniteteve vendore për të ndërtuar axhendën vendore të sigurisë dhe përditësimin e saj në vazhdimësi.
6. KVSP miraton, zbaton, dhe rishikon planin shumë-aktorial vendor.
7. Plani shumëaktorial për parandalimin dhe luftën ndaj krimit në nivel vendor është një dokument i cili përfshin tërësinë e risqeve të vlerësuara, intensitetin e tyre, si dhe masat përkatëse, institucionet përgjegjëse dhe afatet kohore për realizmin e tyre. Afati i zbatimit të Planit është vjetor dhe përditësohet në vazhdimësi.
8. Institucionet përgjegjëse të përfaqësuara me anëtarë në KVSP do të shkëmbejnë informacione në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe KVSP do të përdorë informacion për të lehtësuar marrjen e vendimeve lokale dhe zgjidhjet e problemeve në partneritet.

## **NENI 6 STRUKTURA**

Këshilli Vendor për Siguri Publike përbëhet nga struktura e mëposhtme:

1. Kryetar.
2. Sekretar.
3. Grupet e punës.
4. Plenumi.

## **NENI 7 KRYESUESI I MBLEDHJES**

Kryetari i Bashkisë është kryesuesi i KVSP-së. Ai ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas në KVSP. Ai kryeson mbledhjet, përgatit axhendën në konsultim me sekretarin dhe thërret mbledhjen. Ai nënshkruan në emër të KVSP-së dokumentet zyrtare (rezolutat, ftesat, deklaratat për shtyp dhe media, etj..). Kryetari përfaqëson KVSP-në në marrëdhënie me të tretët, duke përfshirë dhe bashkëpunimet me organizmat ndërkombëtare. Informon Këshillin Bashkiak Durrës për veprimatrinë e KVSP-së së paku një herë në vit.

## **NENI 8 SEKRETARI**

1. KVSP cakton sekretarin teknik të KVSP i cili është një punonjës i bashkisë.
2. Sekretari teknik, në bashkërendim të ngushtë me kryetarin e KVSP, kryen detyrat si më poshtë:
  - a) harton procesverbalet e mbledhjes, shkresat apo aktet e ndryshme të KVSP, mbanjen e arkivës dhe protokollit të KVSP;
  - b) protokollon procesverbalet e mbledhjes;



- d) dërgon dhe ndjek njoftimet dhe veprime të tjera të sekretarisë;
  - e) përgatit materialin, rekomandimet apo vendimet e marra pas çdo takimi të KVSP;
  - f) mban listë-prezencën e anëtarëve të pranishëm të KVSP dhe personave të tjerë të pranishëm në mbledhje;
  - g) koordinon me Drejtorinë e Kabinetit për përgatitjen e njoftimeve për publikim;
  - h) koordinon me sektorin e IT-së për publikimin e njoftimeve apo materialeve që do të publikohen;
  - i) kryen veprimet për publikimin e njoftimeve dhe akteve në faqen zyrtare të bashkisë apo në media duke koordinuar punën me koordinatorin për informim dhe njoftimet publike.
  - j) krijon kushtet e përshtatshme për zhvillimin e mbledhjeve dhe veprimtarive të KVSP.
3. Sekretari teknik merr pjesë në mbledhjet e KVSP.

## NENI 9 GRUPET E PUNËS

Për çështje të veçanta, krijohen grupe të posaçme (ad hoc), të përbëra nga përfaqësuesit e institucioneve në KVSP. Grupi i punës do të hartojë dhe formulojë në mënyrë të detajuar raporte, rekomandime, pyetje etj. Anëtarët e grupeve të punës raportojnë tek drejtuesit e institucioneve që ata përfaqësojnë mbi gjetjet nga procesi i monitorimit të planit vjetor shumë aktorial. Grupi i punës mbështet sekretarin mbi dakordësimin e axhendës së takimeve konsultuese publike dhe merr pjesë në mbledhjet e KVSP-së.

## NENI 10 PLENUMI

Plenumi është organi vendimarrës i KVSP-së dhe përbëhet nga anëtarët e tij. Plenumi do të mbledhet rregullisht çdo tre muaj. Për raste specifike organizohet mbledhje me kërkesë të kryetarit ose të shumicës së anëtarëve të KVSP-së.

## NENI 11 MBLEDHJET E KVSP

1. Mbledhja e KVSP ushtron, por nuk kufizohet në kompetencat e mëposhtme:
  - a) Miraton, vlerëson zbatimin dhe rishikon planin shumë-aktorial vendor;
  - b) Përcakton drejtimet kryesore të axhendës së sigurisë publike në nivel vendor;
2. Mbledhjet e KVSP mbahen së paku 2 herë në vit. Ato zhvillohen në ambientet e bashkisë, me përjashtim të rastit kur Kryetari vendos ndryshe.
3. Në rastet e ngjarjeve të ndryshme të papritura apo me një ndjeshmëri të veçantë, Kryetari mund të realizojë mbledhje me anëtarësi më të vogël pjesëmarrësish që lidhen drejtpërdrejtë me problematikën.
4. Kryetari i KVSP i thërret dhe i kryeson mbledhjet e KVSP. Ftesa me rendin e ditës dhe materialet për shqyrtim u dërgohen anëtarëve të KVSP së paku 5 ditë punë para mbledhjes së radhës.
5. KVSP zhvillon punën në bazë të rendit të ditës të miratuar nga kryetari i KVSP.



6. Kryetari i KVSP jep fjalën, drejton debatin dhe përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës.
7. Pas mbylljes së diskutimeve mes tyre, anëtarët e KVSP dakordësojnë vendime/akte me konsensus të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
8. Vendimet/aktet e miratuara në mbledhje nënshkruhen nga kryetari i KVSP. Sekretari merr masa për t'i shpërndarë një kopje të tij çdo anëtar.

## NENI 12 VENDIMARRJA DHE PROCESI I VOTIMIT

KVSP mund të mbajë mbledhje nëse në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit. Në rast të rezultatit të barabartë të votimit, vota e kryesuesit është vendimtare. Procesi i votimit është i hapur dhe nuk lejohet abstenimi.

## NENI 13 BASHKËPUNIMI

KVSP informon brenda 3 ditëve pune autoritetet/institucionet përgjegjëse mbi gjetje dhe rezultatet e arritura në lidhje me sigurinë dhe rendin publik. KVSP dërgon rekomandimet për masat që do të merren tek institucionet përgjegjëse dhe këto të fundit raportojnë mbi aktivitetet që do të kryhen për të zgjidhur problemin e sigurisë publike të diskutuara në mbledhjet e KVSP-së.

KVSP bashkëpunon me të gjitha institucionet, pjesë në KVSP, për të arritur rezultate të prekshme për parandalimin e kriminalitetit, dhunës në familje, sjelljeve antishoqërore si dhe për çdo çështje që lidhet me sigurinë publike. Në varësi të temave të rendit të ditës, KVSP fton në mbledhje përfaqësuesit e institucioneve/grupe të interesit edhe nëse nuk janë pjesë e KVSP-së, për të diskutuar çështjet përkatëse. Fryma që përshkon organizimin e mbledhjeve dhe komunikimin në mbledhjet e KVSP-së është fryma e bashkëpunimit dhe gjithëpërfshirjes. Vendimet e marra nga KVSP kanë natyrë këshillimore për institucionet dhe të gjithë anëtarët ftohen të marrin në konsideratë këto vendime në planifikimet dhe punën e tyre të përditshme.

## NENI 14 KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

1. KVSP komunikon me publikun pas çdo mbledhjeje përmes një komunikate për mediat, e cila, sipas natyrës së çështjeve të trajtuara, informon së paku për:
  - a) kohën e mbledhjes;
  - b) pjesëmarrjen;
  - c) çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës;
  - ç) thelbin e diskutimeve të KVSP.
2. Njoftimi për publikun përgatitet nga sekretari.
3. Kryetari i KVSP urdhëron publikimin e njoftimit brenda 3 ditë/pune nga zhvillimi i mbledhjes.



**NENI 15**  
**DISPOZITA KALIMTARE**

Ndryshimet dhe plotësimet në këtë rregullore do të bëhen sa herë të ketë ndryshime në legjislacionin në fushën e sigurisë publike.

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Bashkiak Durrës.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 766/<sub>2</sub> prot.

Durrës, më 13 . 12 .2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.174 datë 01.12.2023 “Për krijimin e Këshilli vendor të sigurisë publike në Bashkinë Durrës dhe miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e tij”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

